

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA**, gjykatë e shkallës së parë penale, me trupin gjykues në përbërje me gjyqtarin Agim Maliqi kryetar i trupit gjykues dhe me gjyqtarët profesionistë Ibrahim Idrizi dhe Sahit Krasniqi, anëtar, si dhe me sekretaren juridike Albana Ajvazi, në lëndën penale kundër të akuzuarve A.M. dhe M.M., për shkak të veprës penale trafikimi me njerëz nga neni 139 par. 1 të KPK-së, si dhe kundër të akuzuarës A.R. për veprën penale mundësim i prostitucionit nga neni 201 par. 1 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë së Qarkut në Prishtinë, PP nr. 168-2/2012 të datës 06.07.2012, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Florije Shamolli Salihu, të akuzuarit A.M. me mbrojtësin e tij me autorizim av. G.R., të akuzuarit M.M. me mbrojtësin e tij me autorizim av. B.E., të akuzuarit A.R. me mbrojtësin e saj me autorizim av. A.I., të dëmtuares V.K.1 e përfaqësuar nga përfaqësuesi i Njësisë për Mbrojtje dhe Përkrashje të Viktimave - Ibrahim Tërstena, pas mbajtjes së shqyrtimit të hapur gjyqësor me datat 30 prill, 16/27 dhe më 28 maj 2013 mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Të akuzuarit:**

**A.M.**, nga i ati I. dhe e ëma S. e gjinisë L., data e lindjes në fsh., komuna e Skënderajt, ku edhe jeton, i martuar babë i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, tregtar, i gjendjes së mirë ekonomike.

**M.M.**, nga i ati B. dhe e ëma F. e gjinisë R., data e lindjes në fshatin, Komuna e Ferizaj, me vendqëndrim të përkohshëm në Zvicër, i martuar babë i dy fëmijëve, i gjendjes së mirë ekonomike, shqiptar, shtetas i Republika së Kosovës.

**A.R.**, nga i ati M. dhe e ëma S. e gjinisë R., data e lindjes, në fsh. Komuna e Vitisë, ku edhe jeton, ka të kryer shkollën fillore, e pa martuar, e gjendjes së mirë ekonomike, me profesion kamariere, e punësuar në motelin “...” në Ferizaj.

## I

**Në bazë të nenit 390 par. 1 nënpar. 3 të KPPK-së**

### **LIROHEN NGA AKUZA**

#### **A.M.**

1. Prej tetorit të vitit 2011 gjer më dt. 06.03.2012, në Ferizaj në lokalin “...”, pronë e N.M. ka trafikuar të dëmtuarën V.K.1 në atë mënyrë që e strehuar në katin e tretë të këtij lokali kinse për të punuar si kamariere duke mbajtur lidhje dashurie dhe duke përdorur me kërcënime duke mbajtur me kontrole të rreptë me qëllim të shfrytëzimit e ka detyruar që të kryej marrëdhënie seksuale me persona të ndryshëm, siç është në lokalin “...” pronë e B.K. në lokalin “...”, pronë e K.M. pastaj në lokalin “...” dhe “...” në Prelez, duke përfituar shuma të ndryshme parash dhe atë 50€ deri në 150€, të cilat para e dëmtuara ishte e detyruar t’ia dorëzoj të pandehurit.

**- meqë nuk është provuar se ka kryer veprën penale trafikimi me njerëz nga neni 139 par.1 të KPK-së.**

#### **M.M.**

2. Nga fillimi i shkurtit të vitit 2012 deri më dt. 07.03.2012 në lokalin – motelin “...”, pronë e tij me qëllim të prostitucionit ka lëshuar lokalin e këtij moteli dhe atë katin e tretë dhomën, V.K.1 në atë mënyrë që i ka mundësuar që të merret me prostitucion ku e njëjta ka kryer shërbime seksuale me klient të ndryshëm me para.

**- meqë nuk është provuar se ka kryer veprën penale mundësimi i prostitucionit nga neni 201 par.1 të KPK-së.**

**E dëmtuara V.K.1 nuk ka paraqitur kërkesë pasurore juridike**

**Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.**

## **II**

**Në bazë të nenit 389 par.1 pika 1 të KPPK-së**

**Ndaj A.R.**

### **REFUZOHET AKUZA**

1. Ditën e pavërtetuar të vitit 2011 e deri më dt. 07.03.2012, e ka mundësuar ushtrimin e prostitucionit në atë mënyrë derisa ka punuar në motelin “...” në Ferizaj, pronë e të pandehurit M., dy klientëve të cilët kanë kërkuar shërbime seksuale me para ua ka siguruar B.M. dhe A.P.1, e njëjta i ka thirr B. dhe A.P.2 dhe e ka vu në kontakt me të njëjtën edhe pse e ka ditur se është viktimë e trafikimi.

**- meqë Prokurori i Shtetit në fjalën përfundimtare është tërhequr nga akuza për shkak se me asnjë provë nuk është provuar se ka kryer veprën penale mundësimi i prostitucionit nga neni 201 par.1 të KPK-së.**

**Shpenzimet e procedurës penale edhe për këtë pjesë të aktgjyimit bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.**

## **A r s y e t i m i**

### **1. Historiku i procedurës**

Prokuroria Publike e Qarkut në Prishtinë, ka paraqitur aktakuzën PP nr.168-2/2012 të datës 06.07.2012, ndaj të akuzuarit A.M. dhe M.M., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje trafikimi me njerëz nga neni 139 par.1 të KPK-së si dhe A.R., për shkak të veprës penale mundësimi i prostitucionit nga neni 201 par.1 të KPK-së.

Me aktvendimi e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, KA.nr. 577/12 të datës 09.08.2012, është konfirmuar aktakuza ndaj të akuzuarit A.M. dhe M.M., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje trafikimi me njerëz nga neni 139 par.1 të KPK-së si dhe A.R., për shkak të veprës penale mundësimi i prostitucionit nga neni 201 par.1 të KPK-së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësor me datat 30 prill, 16/27 dhe më 28 maj 2013, kurse Prokurori i Shtetit Florije Shamolli Salihu, në fazën e ndryshimit të akuzës, ndryshoj akuzën,<sup>1</sup> ashtu siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Prokurori i Shtetit në fjalën përfundimtare, ka mbetur pranë akuzës së ndryshuar në dispozitiv ndaj të akuzuarit A.M., për shkak të veprës penale trafikimi me njerëz nga neni 139 par.1 të KPK-së, duke i propozuar Gjykatës që i akuzuari të shpallet fajtorë dhe të dënohet me dënim sipas ligjit.

Ndaj të akuzuarit M.M. ka rikualifikuar veprën penale duke e akuzuar për shkak të veprës penale mundësimi i prostitucionit nga neni 201 par.1 të KPK-së, duke i propozuar Gjykatës që i akuzuari të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet dënim sipas ligjit.

Kurse sa i përket të akuzues A.R., Prokurori i Shtetit është tërhequr nga akuza, për shkak të veprës penale mundësimi i prostitucionit nga neni 201 par.1 të KPK-së.

## **2. Mbrojtja e të akuzuarve**

I akuzuari A.M., në fillim të shqyrtimit gjyqësor e deri në fjalën përfundimtare nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale trafikim me njerëz nga neni 139 par. 1 të KPK-së, kurse

---

<sup>1</sup> Shih procesverbalin e shqyrtimit kryesor gjyqësor, pjesën e ndryshimit të akuzës.

më tutje në mbrojtjen e tij nuk ka kontestuar faktin se prej nëntorit të vitit 2011 së bashku me V. të cilën e ka njohur para një viti kanë ardhur në Ferizaj, ashtu që së pari janë ndalur te restoranti ” ...” në Ferizaj, ku V. ka kërkuar punë dhe ka punuar si valltare në këtë restorant më vonë ka punuar edhe në restorante tjerë, pastaj ka punuar në restorant – kafe te B., në motel ...i dhe në kafiteri të tjera. Nuk e ka kontestuar faktin se me të njëjtën kanë qëndruar për dy net me një banesë tek stacioni i autobusëve dhe atë në banesën e K., kurse më vonë V. ka filluar të banoj dhe punoj tek kafiteria e B.. Më vonë kanë banuar së rreth një muaj në hotelin “...”, e që më vonë kanë filluar të banojnë së bashku në motel “...” dhe atë në periudhë rreth tri javë. Më tutje në mbrojtjen e tij ka shtuar se është e vërtetë që V. ti ketë dhënë para atij me shuma të ndryshme 5€, 10€ e që gjatë kësaj periudhe kjo shumë përafërsisht mund të arrijë rreth 700 €, por meqë kanë pasur lidhje dashurie mes vete dhe nuk ia ka marrë nën kërcënim por vullnetarisht e ndonjëherë edhe i ka dhënë para me mundësitë që ka pasur. Po ashtu më tutje në mbrojtjen e tij ka shtuar se asnjëherë nuk kam biseduar me pronarë të kafiterive për pagesën e V. por është e vërtetë se gjatë një bisede që ka pasur V. me M. rreth kushteve të punës ka qenë prezent aty, por pa ndërhyrë në këtë marrëveshje

Kurse në fjalën e tij përfundimtare ka propozuar Gjykatës që ta liroj nga akuza meqë ndjehet i pafajshëm për veprën penale për të cilën është akuzuar.

I akuzuari M.M., në fillim të shqyrtimit gjyqësor nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale (trafikim me njerëz nga neni 139 par.1 të lidhur me nenin 23 të KPK-së), gjithashtu edhe mbas ndryshimit/rikualifikimit të veprës penale mundësim i prostitucionit neni 201 par. 1 të KPK-së, nuk e pranoi fajësinë për këtë veprë. Gjatë mbrojtjes së tij nuk e konteston faktin se është pronar i motelit “...” në Ferizaj, i cili motel ka filluar të punoj pas renovimit me 10 shkurt të vitit 2012, aty kanë punuar si kamariere A.R. dhe V.K.1 e që të fundit e ka njohur përmes kushëririt të tij K.M. i cili edhe i ka propozuar që ta punësoj atë. Po ashtu ka pohuar se gjatë bisedës me V. për punësimin e saj ka qenë prezent edhe A.1, i cili është prezantuar si dashnor i saj, por, se i njëjti me të kanë banuar së bashku deri sa asnjëherë pagesën për punën e V. nuk ia ka bërë ndonjë personi tjetër e as A.1.

Sa i përket ditës kur e dëmtuara e ka lëshuar punën i njëjti shton se vetëm e ka lutur që të mos e lëshoj punën deri sa të gjejë një punëtoare tjetër dhe se ka qenë i panevojshëm që policia të shkoj dhe ti marrë sendet e saj nga moteli, kurse në fjalën e tij përfundimtare ka kërkuar lirimin e tij nga akuza.

Po ashtu edhe i akuzuari A.R., në fillim të shqyrtimit gjyqësor nuk ka pranuar fajësinë gjithashtu duke deklaruar se ka punuar në motelin “...” në Ferizaj dhe atë si kamarierë e përveç kësaj gjatë shërbimit të klientëve ka pirë pije së bashku me ta ashtu që për çdo pije e cila ka kushtuar 5€ ka marrë 1€ për vete ashtu siç janë marrë vesh edhe me pronarin, por se për këtë nuk ka qenë e detyruar por e ka bërë për përfitim. Më tutje ka shtuar se ka banuar në këtë motel, e ka njohur V. e cila po ashtu ka punuar kamarierë e po ashtu ka njohur A.P.1 dhe B.M. të cilat nganjëherë kanë pirë kafe në këtë motel por ka mohuar se u ka gjetur klient për marrëdhënie seksuale.

### **3. Provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor**

Pasi që të akuzuarit A.M., M.M. dhe A.R., nuk kanë pranuar fajësinë për asnjë pikë të dispozitivit të akuzës, Gjykata ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëri me tjetrin, vërtetoj gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi:

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë:

- pjesërisht nga mbrojtja e vet të akuzuarve;
- nga dëshmitë e të dëmtuarës/dëshmitares V.K.1;
- nga dëshmia e dëshmitarëve V.K.2, Xh.K., H.K., Xh.Sh., B.K., B.G. dhe N.M.;
- nga shikimi dhe leximi në transkriptim të masave të fshehta të përgjimit telefonik;
- nga shikimi në certifikatën e regjistrimit të biznesit NPH “...”
- nga shikimi dhe leximi në vërtetimin mbi konfiskimin e sendeve.

### **4. Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor**

Nga dëshmia e dëshmitares-të dëmtuarës V.K.1, vërtetohen se e njëjta që nga tetori i vitit 2011, ka ardhur në Ferizaj dhe atë fillimisht së bashku me A.1 e që janë takuar me Xh.Sh., të cilën edhe e ka njohur më herët. Fillimisht ka punuar si valltare në restorant “...”, e pastaj edhe në restorante të tjera, kurse gjatë muajit nëntor dhe dhjetor 2011 ka punuar në

kafiterinë e B.K., ashtu që gjatë punës së saj është ulur me klient të ndryshëm ku me të njëjtit kanë pirë së bashku pije të ndryshme, më tutje dëshmitarja në rrëfimin e saj shton se më vonë ka filluar të punoj edhe në motelin "...", e në të cilin hotel edhe ka banuar ashtu që me dt. 6 mars 2013, ka ndërprerë punën në këtë restorant, me rastin e ndërprerjes së punës ka pasur një mosmarrëveshje me pronarin e motelit – të akuzuarin M.M., dëshmitarja po ashtu ka deklaruar se gjatë punës që ka bërë në restorantin "...", ajo njëkohësisht edhe ka banuar aty, e që puna e saj ka qenë si kamerier si dhe ka shoqëruar klientët gjatë pijeve në këtë restorant, nuk e kontestuar faktin se A.1 ndonjëherë i ka dhënë të holla, por këtë e ka bërë jo nga detyrimi i tij, por, nga fakti se i ka ndihmuar atij, e për më tepër këta kanë pasur edhe marrëdhënie dashurie në mes vete, por asnjëherë nuk e ka pyetur të akuzuarin në lidhje me punën që do të bënte nëpër kafiteri të ndryshme.

Në cilësinë e të dëmtuarës nuk i është bashkangjitur ndjekjes penale dhe nuk ka paraqitur kërkesë pasurore-juridike.

Nga përmbajtja e dëshmisë së kësaj dëshmitare Gjykata vlerëson se nga kjo dëshmi nuk mund të bihet ndonjë konkludim inkriminues përkitazi me të akuzuarit, për më tepër këto dëshmi janë konsistente edhe gjatë procedurës hetimore meqë asnjëherë nuk ka pretenduar se i akuzuari A.M. e ka trafikuar atë por e ka konsideruar si dashnor përkatësisht siç shprehet në fjalën përfundimtare se *"...në rastet kur kam komunikuar me SMS me A.1– të akuzuarin unë të njëjtin e kam njoftuar vetëm për shkak se kam konsideruar se e kam burrë dhe asnjëherë nuk e kam informuar se i njëjti më ka detyruar për një gjë të tillë, e aq më tepër nuk më ka detyruar asnjëherë A.1 që të kem marrëdhënia seksuale me persona tjerë."*<sup>2</sup>

Sa u përket dëshmive të dëshmitarëve B. G. dhe N.M., këto dëshmi nuk kanë paraqitur kurrfarë relevance në shtjellimin e kësaj çështje përveç që dëshmitari B. G. ka prezantuar fakte se ka sjellë në Ferizaj me automjet A.1 dhe një femër që ka qenë së bashku me të, kurse dëshmitari N.M. ka prezantuar fakte të pakontestueshme dhe atë se V. ka punuar në motel si kamariere, ka banuar aty dhe se të akuzuarin A.1. e ka njohur si figurë, andaj mbi këtë bazë Gjykata nuk e sheh të nevojshme që këto dëshmi ti trajtoj më tutje.

Po ashtu edhe dëshmitari Xh.K. ka prezantuar fakte të pakontestueshme se V. është larguar nga shtëpia e tij pa leje të tij diku në vitin 2011, duke shtuar se më vonë ka qenë në

---

<sup>2</sup> Fjala përfundimtare e të dëmtuarës faqe 24 e procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor.

njohuri se është duke punuar në kafiterinë e B.K., me të cilin edhe kanë pirë kafe së bashku ashtu që ka kuptuar se ajo është duke shërbyer vetëm brenda shankut.

Edhe kjo dëshmi nuk ka paraqitur ndonjë të dhënë që do të ishte e vlefshme përkitazi me pretendimet për të cilat është zhvilluar shqyrtimi gjyqësor përkitazi me veprimet inkriminuese, andaj edhe kjo dëshmi nuk është e nevojshme që të vlerësohet më tutje.

Nga dëshmia e dëshmitares Xh. Sh. e njohur edhe me nofkën “K.” është vërtetuar se V. dhe A.2 kanë banuar në banesën e saj dhe atë dy netë dhe se gjatë kësaj kohe kanë ardhur aty familjarët e saj dhe të cilët i kanë gënjyer se V. është duke punuar së bashku me të në një market edhe pse kanë punuar si valltare në kafe “...”, e pasi që janë larguar nga banesa iu ka telefonuar prindërve të V. dhe u ka treguar se e njëjta nuk është duke banuar me të dhe është duke punuar në kafiteri.

Edhe nga përmbajtja e kësaj dëshmitare nuk është arritur që të nxirret ndonjë përfundim inkriminues përkitazi me veprimet e të akuzuarit, pos të dhënës që kanë banuar së bashku që nuk është kontestuar e as mohuar edhe nga i akuzuari.

Përmbajtja e dëshmisë së dëshmitarit B.K. ka vërtetuar se i njëjti është pronar i kafitertisë “...” në Ferizaj, se V. ka punuar fillimisht një kohë prej 2-3 javë me pëlqimin paraprak të prindërve të saj, përkatësisht pasi që ka shkuar në Skënderaj dhe ka biseduar me prindërit e saj babin dhe nënën, pas kësaj periudhe dy deri në tri javë në kafiteri ka shkuar A.M. dhe ka kërkuar prej V. që të mos vazhdoj të punoj në këtë kafiteri, pastaj pas një kohe prapë ka pasur kontakte me prindërit e saj e pas premtimeve se A.1 nuk do ta pengoj më në punë V. ka punuar prapë për një periudhë të shkurtër. Ka ditur se A.1 është dashnori i V. dhe këtë e ka kuptuar nga V., kurse konsideron se A.1 e ka ndal të punoj nga xhelozia.

Dëshminë e këtij dëshmitari Gjykata e ka trajtuar në mënyrë tejet të kujdesshme nga fakti se e dëmtuara ka punuar në kafiterinë e tij dhe se padyshim ka qenë një rivalitet mes tij si pronar i kafitertisë “...” dhe të akuzuarit A.M. i cili nuk e ka lejuar V. të punoj në këtë kafiteri, por megjithatë dëshmia e tij është objektive dhe e saktë sidomos në sqarimin e momentit kur e dëmtuar e braktisë punën në kafiteri duke u shprehur se “... gjatë bisedës që ka bërë V. me akuzuari A.1 kam kuptuar se ai po xhelozon që V. po punën në kafiteri, por



*edhe vetë V. më ka thënë një gjë të tillë.”<sup>3</sup>, duke vazhduar edhe me sqarimin e një momenti tejet interesant që ndërlidhet me pretendimet e akuzës, “... në këtë kafiteri përkatësisht në kohën kur aty ka punuar V. e që kam qëndruar pothuajse zakonisht në mbrëmje unë nuk e kam parë asnjëherë A.1 që të ketë sjellë ndonjë person tek V. me qëllim të marrëdhënieve seksuale me të e as nuk e kam vërejtur që A.1 ta ketë marrë V. dhe ta ketë dërguar diku gjatë orarit të punës”<sup>4</sup>, kurse përfundimisht ka mohuar se ka paguar të akuzuarin A.M. për punën e bërë nga V. “... të hollat ia kam dhënë personalisht asaj por asnjëherë para nuk i kam dhënë A.1 për punën që ka bërë V.”<sup>5</sup>.*

Nga dëshmia e dëshmitares H.K. është vërtetuar se e dëmtuara V.K.1 diku në muajin shtator të vitit 2011 ka dalë nga shtëpia duke i thënë se po shkon për të punuar në Prishtinë përkatësisht në një shitore të këpucëve e pasi që përmes kontaktit telefonik ka kuptuar se është në Ferizaj, së bashku me vëllain dhe djalin kanë shkuar në Ferizaj, pa arritur ta di se ka qenë banesë apo hotel ai vend por pasi që kanë hyrë në dhomën ku ka banuar V. dhe kanë biseduar me të duke i thënë asaj që të kthehet në shtëpi, por që ajo nuk ka pranuar edhe pse e ka ditur se me të qëndron edhe A.1. Edhe pse fillimisht nuk e ka ditur se çka është duke punuar vajza e që më vonë edhe prej telefonatave nga K. ka kuptuar që është duke punuar tek B. dhe se për këtë e ka ditur se është duke punuar në shank. Më tutje po ashtu ka shtuar se gjatë një bisede që ka pasur me A.1 i njëjti i ka thënë se i njeh të gjithë policët e Skenderajt dhe Ferizajt dhe i ka shokë ata por se kjo bisedë ka qenë tepër nervoze nga të dy palët e sidomos nga ana e saj nga fakti se A.1 nuk i ka pëlqyer se e ka ditur se është i martuar dhe nuk ka dashur që ta prishi familjen e tij për shkak të vajzës së saj V., po ashtu më tutje ka sqaruar edhe bisedën që ka pasur me L. e cila po ashtu e ka njoftuar se A.1 e ka maltretuar dhe një herë e ka goditur me shuplakë V., por përfundimisht rrëfimin e saj e përmbyllë me fjalët se ka thënë fjalë që ka dëgjuar nga të tjerët, duke pohuar se V. pothuajse çdo javë e ka vizituar në shtëpi dhe ndonjëherë i ka sjellë të holla në shuma të ndryshme ndonjëherë 50€, 20€, 30€ apo ndonjë shumë tjetër. Kurse sa i përket të akuzuarit tjetër M.M. këtë person as që e ka njohur fare.

Kurse nga përmbajtja e dëshmisë së dëshmitares V.K.2 është vërtetuar se me dt. 17.2.2012 pasi që V. ka shtëpi në Skënderaj dhe ka qëndruar një natë kurse të nesërmen së

---

<sup>3</sup> Shih deklarinimin e dëshmitarit faqe 14 e procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor.

<sup>4</sup> Po aty

<sup>5</sup> Po aty

bashku kanë shkuar në Ferizaj, në motelin “...” dhe aty janë vendosur në dhomën ku e njëjta ka banuar, prezent ka qenë edhe A.M. përndryshe e ka njohur se ka qenë dashnor i motrës. Po ashtu aty kanë qenë edhe M. – pronari i motelit si dhe A.2 dhe pasi që kanë pirë nga një kafe në motel ka shkuar në dhomë atje kam qëndruar së bashku me motrën e saj e cila pastaj ka dal për të punuar në restorant dhe është kthyer rreth orës 4:00 para mëngjesit. Ka mohuar dëshminë e saj gjatë procedurës hetimore se e ka parë duke e goditur A.1 V. dhe se i ka kërkuar para dhe se në dhomë kanë pasur marrëdhënie seksuale (A.1 dhe V.), si dhe faktin se e ka parë duke e goditur V. në shankun e hotelit. Po ashtu ka mohuar faktin se A.1 i ka ofruar punë asaj për 50 apo 100€.

Padyshim se vlerësimin më të rëndësishëm Gjykata do ta bëjë përkitazi me dëshmitaret H.K. dhe V.K.2 dhe atë për arsyet si në vijim:

- së pari të njëjtat kanë raporte familjare me të dëmtuarën V.K.1, njëra është nëna kurse tjetra motra e saj;

- se të njëjtat nuk kanë qenë konsistente në dëshmitë e tyre gjatë fazave të procedurës penale, përkatësisht kanë ndryshuar esencialisht dëshmitë e tyre;

- dhe përfundimisht nga këto dëshmi është konstruktuar skeleti i akuzës ndaj të akuzuarve.

Andaj nga këto arsye është më se e nevojshme që këto dëshmi të vlerësohen në mënyrë sistematike në të gjitha fazat e procedurës penale dhe assesi në mënyrë fragmentare nga njëra fazë në tjetrën. Gjithsesi fillimisht duhet theksuar se gjatë shqyrtimit gjyqësor dëshmitaret kanë dhënë dëshmi të cilat kanë qenë tejet favorizuese për të akuzuarin e që është tejet simptomatike pse ndodhi kjo kur në fazën hetimore kanë qenë dëshmi mjaft të disfavorshme.

Dëshmia e këtyre dëshmitareve në fazën hetimore Gjykata nuk u besoi dhe atë nga faktet që do ti paraqesim në vijim:

- se në këtë fazë vërehet një frustrim i lartë i dëshmitareve sa i përket raporteve mes të akuzuarit dhe dëmtuarës V., meqë ishin kundër lidhjeve mes të akuzuarit dhe të dëmtuares;

-dëshmitarja H.K. gjatë hetimeve më shumë pohonte në tërësi vetëm atë çka kishte dëgjuar nga të tjerët në rend të parë nga K., L. dhe B.K. dhe nuk pohonte asgjë që kishte parë vet e që këto dëshmi edhe vet i mohon më vonë “... K. më tregoi se këtu e ka sjellë një person me emrin A.I nga Klina, i cili kohë pas kohe e maltreton...” duke vazhduar se “ ... një shoqe e vajzës time L., më tregoi se e ka parë A.I duke e goditur me shuplakë V...” “... edhe B. nga Ferizaj i cili e mban një lokal kafiteri te i cili ka punuar V. më herët. I njëjti ka ardhë te na në shtëpi në Skenderaj dhe më ka informuar se njëfarë A.I i cili e ka sjellë V. te ai në punë është duke e maltretuar...”<sup>6</sup>

- dëshmitaret pa përjashtim nuk e mohuan asnjëherë se e dëmtuara i kishte vizituar në shtëpi pothuajse rregullisht duke iu dhënë edhe para që vërteton se e njëjta mund të lëvizte vazhdimisht dhe pa asnjë vështirësi gjatë periudhës që bashkëjetonte me të akuzuarin.

Andaj për arsyet e lartcekura Gjykata vlerëson se këto dëshmitare nuk kanë arritur që të paraqesin dëshmi të besueshme që vërtetojnë pohimet e akuzës për më tepër edhe nga dëshmitë e tyre konkludohet se ishte pikërisht në vullnetin e “të dëmtuarës” që të rrinte dhe të ushtronte profesionin e kamarieres dhe valltares në këto lokale dhe si të sqarohet ndryshe që edhe vet fakti se nëna , vëllai dhe daja i saj e lutën të kthehej në shtëpi por ajo nuk u kthye dhe vazhdoi të qëndroj në motel duke vazhduar me punën e saj.

Nga regjistri i telefonatave për numrin e telefonit që ka shfrytëzuar e dëmtuara V.K.1 (nr. ...)<sup>7</sup>, është provuar se në mes të saj dhe të akuzuarit A.M. (nr. ...), ka pasur komunikim të dyanshëm dhe atë përmes bisedave telefonike dhe sms-ve, me ç’rast gjatë këtij komunikimi duke u ndërlidhur me faktin se të njëjtit kanë bashkëjetuar në mes vete, paraqesin diçka normale dhe nga to nuk mund të nxirret ndonjë konkludim që do të inkriminonte të akuzuarin, për më tepër komunikimeve që i referohen ashtu siç pretendon Prokurori i Shtetit . përkundër faktit se janë selektuar dhe janë përmendur vetëm disa nga bisedat dhe sms edhe pse do të ishte e logjikshme që të njëjtat të trajtohen në tërësi, por, megjithatë disa nga komunikimet e zhvilluara

- Me dt. 03.01.2012 ku i akuzuari i drejtohet të dëmtuarës “a e din çka të kam thënë dje për tavolinën kur të vij unë atje punë ka me të dal e din ti çka të gjen”

<sup>6</sup> Procesverbali i marrjes në pyetje të dëshmitares H.K. dhënë në PQP me dt.24.05.2012

<sup>7</sup> I cili përgjim është bërë në bazë të urdhëresës së GJQ në Mitrovicë me dt. 27.01.2012

- me dt. 7.2.2012 e dëmtuara i tregon të akuzuarit “*se më ka ardh një mesazh për me punu në ...*” e njëjta e pyet “*çka me ba*”,

- me dt. 13.2.2012 e dëmtuara e thërret të akuzuarin duke i thënë se “*D. mi pruni 50€*”, i njëjti thot “*dil pra pije një kafe se nuk ka kuptim dhe leja si mirë*”,

- me dt. 14.2.2012 e dëmtuara i thotë të akuzuarit “*erdh ai maxhupi që ka thanë se ka pare, a mu ul*”, i njëjti përgjigjet “*ulu*”,

- me dt. 16.2.2012 e dëmtuara e pyet të akuzuarin “*a ban me shku deri te marketi “...” se ka me ble diçka*”,

- me dt. 20.2.2012 e dëmtuara e thërret të akuzuarin i thotë “*T. ka kallxu krejt te shpia*”, i njëjti e pyet “*çka krejt*”, e dëmtuara përgjigjet “*se A.1 po e shitka V. nëpër kafe*”,

- me dt. 20.2.2012 e dëmtuara e njofton të akuzuarin se “*sot i kam fituar vetëm 13 €*” dhe i tregon se “*i kam edhe 20 tjera të mia*”,

- me dt. 26.2.2012 i akuzuari i thot të dëmtuarës “*kqyre bëne naj lek, preke ka pak këmbëve, ky kallet nisja pak mirë dhe mos e le me u qu pa 50€*”,

- me dt. 13.2.2012 e dëmtuara V., bisedon në tel. me personin D. me fjalët “*bimi do pare*” pastaj vazhdon biseda “*po të pres tek hotel “...” dhe po të pres në dhomën nr. 1 në katin e parë*” e dëmtuara përgjigjet “*do të vij pasi ti kryej punët e mia pasi jam te frizerka*”,

- me dt. 26.2.2012 e dëmtuara e thërret të akuzuarin dhe i thot “*deri tani kam nejt me atë plakun (bëhet fjalë për Xh.), por nuk më ka lënë asnjë para, por më tha se kur të dalim*”, i akuzuari thot “*lypja 5000 copa e tani do të vij kur të duash*”,

- me dt. 28/2.2012 e dëmtuara e njofton të akuzuarin se “*këtu është Femija u piav, mi dha vetëm 10€*”, i akuzuari përgjigjet “*kqyr gjan futja*”,

- me dt. 29.2.2012 e dëmtuara e njofton të akuzuarin me fjalët “*B. më tha veç po i nxjerri do para dhe po vij*”, i akuzuari përgjigjet “*fol ti e qetë që të lej të besoj se ti po e don, e sillja rreth 500€*”.

Këto komunikime të zhvilluara janë objektive nga fakti se i akuzuari dhe e dëmtuara nuk ishin në dijeni për përgjimet që u bëheshin atyre, bisedat dhe sms-ve ishin spontane dhe të natyrshme, andaj edhe paraqesin një besueshmëri të lartë, por përkundër kësaj se këto komunikime janë selektuar dhe janë trajtuar si të shkëputura gjithsesi këto vërtetojnë se mes

tyre ka pasur lidhje të dashurisë dhe asgjë nga përmbajtja e tyre nuk paraqet ndonjë inkriminim për të akuzuarin.

## **5. Analiza e ligjit material**

Trupi gjykues e sheh të nevojshëm analizën dhe vlerësimin e veprës penale të trafikimit, e cila është përkufizuar me dispozitën e nenit 139 (8) (1) i KPK-së e cila përcakton:

*“Rekrutim, transportim, transferim, strehim ose pranim i personave me anë të mjeteve të kërcënimit ose të përdorimit të forcës apo me forma të tjera të detyrimit, rrëmbimit, falsifikimit, mashtrimit, apo keqpërdorimit të pushtetit apo të pozitës ose të një pozite të ndjeshme ose me anë të dhënies a marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit, që ka kontroll mbi personin tjetër me qëllim të shfrytëzimit.”*

Përkufizimi i trafikimit është i ndërlikuar, por bëhet i qartë nëse zberthehet në tri komponentët kryesore e që janë të domosdoshme për ekzistimin e kësaj vepre penale dhe atë: *veprimi, mënyrat apo mjetet e paligjshme dhe për qëllim të shfrytëzimit.*

*1. Elementi i veprës apo veprimit përfshinë: rekrutimin, transportimin, transferimin, strehimin apo pranimin e personave.*

*2. Mënyrat apo mjetet e paligjshme përfshinë: kërcënimin ose përdorimin e dhunës apo formave të tjera të detyrimit, rrëmbimit, falsifikimit, mashtrimit të keqpërdorimit të pushtetit apo të pozitës apo të një pozite të ndjeshme apo me anë të dhënies apo marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit që të ketë kontroll mbi personin tjetër<sup>8</sup>.*

*3. Të ekziston qëllimi i posaçëm i shfrytëzimit: e që fjala “shfrytëzim” përkufizohet ajo që “përfshin ndër të tjera shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, shërbimeve ose punës së detyruar, skllavërisë ose veprimeve të ngjashme me skllavërinë, robërisë ose heqjes së organeve.”*

---

<sup>8</sup> Ky kusht aplikohet vetëm në rastet kur viktimat e trafikimit është e moshës madhore,

Kurse në rastin konkret mungon së pari komponenti i parë *elementi i veprimit* dhe është e paqartë se cili është veprimi konkret i të akuzuarit, është e pakontestueshme se i akuzuari dhe e dëmtuara kanë banuar së bashku por strehimi ishte bërë në sajë të marrëveshjes së saj dhe të akuzuarit M.M. për punën që bënte ajo dhe këtu as që ishte fare i implikuar i akuzuari A.M., u vërtetua se vet e dëmtuara kishte bërë marrëveshje për banim vet ajo kishte pasur probleme për largim nga banesa dhe nuk shihet asnjë ndikim i të akuzuarit A.M., për më tepër se ky strehim nuk ishte i detyruar vërtetohet edhe me faktin se e dëmtuara po lëvizte lirshëm nga Ferizaj në Skenderaj dhe anasjelltas dhe këtë e pohuan të gjithë dëshmitarët pa dallim për shkuarjet në shtëpinë e saj dhe qëndrimin atje të herë pas herëshëm..

Po ashtu elementi i veprimit duhet të ndërlidhet me komponentën e dytë *“kërcënimit”*, i cili nuk është vërtetuar me asnjë provë të vetme, përkatësisht nuk është vërtetuar se ka ndodhur diçka e tillë, meqë edhe vet pohon se ishte nën vullnetin e saj të punonte valltare dhe kamariere dhe nuk e kërcënonte askush për diçka të tillë.

E që në tërësinë e saj mungon edhe komponenta e tretë *“qëllimi i shfrytëzimit seksual”*, që duhet të jetë prezent për t’u realizuar kjo vepër penale, meqë nuk është vërtetuar se e dëmtuara të ketë pasur marrëdhënie seksuale me ndonjë person në këto lokale për më tepër nuk është kontestuese se ajo po vallëzonte dhe po pinte pije me mysafirët në këto lokale (që nuk inkriminohen si veprime që hyjnë në fushën penale) por së paku edhe me një person nuk është vërtetuar se ka pasur marrëdhënie seksuale dhe është shfrytëzuar nga ana e të akuzuarit.

Andaj, është e çartë se këto të tri komponentë duhet të ndërlidhen në mënyrë zingjirore njëra me tjetrën dhe çdo shkëputje paraqet njëkohësisht mosrealizim të kësaj vepre penale.

Po ashtu sa i përket të akuzuarit M.M. është e nevojshme të analizohen dispozita e nenit 201 par. 1 të KPK-së me ç’rast përkufizohet:

*“Kushdo që me dije rekruton, organizon ose ndihmon një person tjetër apo ia lëshon lokalet një personi tjetër për qëllime të prostitucionit dënohet...”*

Andaj, Gjykata vlerëson se pretendimet se është kryer një veprë e tillë janë të paqëndrueshme nga arsyetimi që do të paraqitet si më poshtë:

Së pari janë të pakontestueshme faktet që do ti paraqesim në vijim se e dëmtuara ka banuar në motelin “...” në Ferizaj, se pronar i këtij moteli ka qenë pikërisht i akuzuari M.M., por nuk është vërtetuar se e njëjta ka ushtruar prostitucion në dhomën e saj.

Gjykata ka vlerësuar se në veprimet e të akuzuarit nuk janë manifestuar asnjë nga elementet e veprës penale mundësimi i prostitucionit nga neni 201 par. 1 të KPK-ës, meqë i akuzuari nuk është kontestues se *“ka lëshuar lokalet”* (dhoma 11 në katin e tretë në hapsirën e motelit “...”) por nuk është vërtetuar *“për qëllim të prostitucionit”*, dhe kjo nuk është vërtetuar në asnjë rrethanë meqë nuk është vërtetuar se është zhvilluar prostitucioni nga e dëmtuara madje as edhe me një person të vetëm.

## **6. Analiza e fjalës përfundimtare të Prokurorit të Shtetit**

Po ashtu, Gjykata e sheh të nevojshme të vlerësoj edhe fjalën përfundimtare të Prokurorit të Shtetit, i cili në fjalën e tij nuk e konkretizon qoftë edhe një veprim konkret të të akuzuarit A.M. pos që citon deklaratimet e dëshmitarëve gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Gjykata në mënyrë të posaçme ka vlerësuar fjalën përfundimtare të Prokurorit të Shtetit sa i përket kësaj pjese të aktgjykimi dhe ka gjetur se nuk është paraqitur asnjë e dhënë bindëse për kryerjen e këtyre veprave penale të paraqitur në fjalën përfundimtare, për më tepër nga analiza e fjalës përfundimtare po thuajse në tërësi është anashkaluar përshkrimi i veprimeve konkrete të të akuzuarit.

Në kontest të kësaj edhe vet përshkrimi i dispozitivit të akuzës në pjesën ku i referohet të akuzuarit A.M. është i paqartë dhe konfuz në pikat që do ti paraqesim në vijim:

- së pari përveç që përdorë fjalinë *“...e ka detyruar që të kryej marrëdhënie seksuale me persona të ndryshëm, siç është në lokalin “...” pronë e B.K. në lokalin “...” pronë e K.M. pastaj në lokalin “...” dhe “.....”*, nuk përshkruan fare mënyrën e realizimit të detyrimit e po ashtu nuk përshkruan se kush janë personat e ndryshëm që u janë ofruar shërbimet seksuale, pastaj kundërvlerën që kanë paguar këta persona pasi bëhet fjalë për një periudhë prej gjashtë

muajve (tetor 2011- 06 shkurt 2013) dhe nuk është konkretizuar qoftë edhe një veprim i vetëm i të akuzuarit e për më tepër një pretendim i tillë nuk u vërtetua nga asnjë dëshmitar i cili nuk pohoi se e njëjta ka kryer marrëdhënie seksuale;

- për të vazhduar më tutje “...duke përfituar shuma të ndryshme parash dhe atë 50€ deri në 150€, të cilat para e dëmtuara ishte e detyruar t’ia dorëzoj të pandehurit...”, është e paqartë se prej nga një konkludim i tillë i Prokurorit të Shtetit se nga rrjedhin këto shuma të parave dhe kur dhe ku i dorëzoheshin të akuzuarit ngase as edhe njëherë nuk vërtetohet një pretendim i tillë se janë dërguar në se ia ka marrë paratë dhe për çfarë shume të parave, nuk kontestohet fakti se e dëmtuara ti ketë dhënë para të akuzuarit por të hollat ia kishte dhënë jo nga kërcënimi apo presioni por nga fakti se ata po bashkëjetonin së bashku dhe në këso lloj raportesh (të bashkëjetesës) është normale dhe e logjikshme që të ndihmojnë njëri-tjetrin;

- dhe përfundimisht në mes tjerash përshkruhet “...duke mbajtur me kontrollë të rreptë ...”, e që pa arritur të vërtetoj qoftë edhe një veprim të këtij kontrolli të rreptë e cila ka mbetur në nivel të supozimeve, pa mbulesë dhe pa asnjë mbështetje, për më tepër asnjëherë nuk mjafton vetëm të përdoret fjala kontroll i rreptë por është e nevojshme që në mënyrë të qartë dhe të konkretizuar të përshkruhet se si është manifestuar, në çfarë forme dhe mënyre ky kontroll.

Andaj nga të gjitha këto që u thanë më lartë e duke marrë parasysh posaçërisht faktin se Gjykata me rastin e vendosjes është e obliguar që të provoj të gjitha faktet në mënyrë të gjithanshme dhe të pa kontestueshme, në favor dhe disfavor të akuzuarit, e posaçërisht këtë duke e ndërlidhur me nenin 3 të KPPK-së, *parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin in dubio pro reo*, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës. E në ndërlidhje të kësaj po ashtu duke pasur parasysh faktin se të gjitha argumentet që janë “*in peius*” ndaj të akuzuarit duhet të vërtetohen me siguri të plotë përkatësisht përtej dyshimit të arsyeshëm (*beyond reasonable doubt*) dhe nëse nuk arrihet një diçka e tillë duhet konsiderohen se nuk ekzistojnë kurse për argumentet që janë “*in favorem*” ndaj të akuzuarit merren se ekzistojnë edhe atëherë kur janë vërtetuar me probabilitet.



Për më tepër është e pa diskutueshme se mbi kënd bie barra e provës për fajësinë e të akuzuarve dhe çdo veprim tjetër i Gjykatës do të kuptohet si e kundërt dhe në këtë mënyrë lëvizje e barrës së provës nga organi i akuzës në të akuzuarit, e cila është në kundërshtim esencial të njërit prej parimeve fundamentale të procedurës penale e përcaktuar me nenin 7 të KPPK-së dhe e garantuar edhe me nenin 6.2 të KEDLNJ.

Andaj Gjykata bazuar në provat e prezantuara për këtë pjesë të aktgjykimit ka konstatuar se nuk është vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer veprat penale në fjalë.

## II

Sa i përket pjesës së dytë të këtij aktgjykimi përkatësisht pjesës së aktgjykimit refuzues Prokurori i Shtetit, në fjalën përfundimtare është tërhequr nga akuza ndaj të akuzuarës A.R., për shkak të veprës penale mundësimi i prostitucionit nga neni 201 par.1 të KPK-së, meqë nga provat e prezantuara në shqyrtimet gjyqësore me asnjë provë nuk është vërtetuar se e akuzuara ka kryer veprën penale në fjalë.

Në bazë të nenit 109 të KPPK-ës nëse konstatohen shpenzime eventuale për pjesët nën II dhe III të aktgjykimit do të paguhet nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, PKR.nr.10/2013**

**Sekretarja juridike,  
Albana Ajvazi**

**Kryetari i trupit gjykues,  
Agim MALIQI**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.